

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME DIBËR SH.A

SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE

SHPALLJE PËR VENDE TË LIRA PUNE

Bazuar ne Ligjin 7961, date 12.07.1995 “Kodi i Punes i Republikes se Shqiperise”, i ndryshuar, mbështetur në Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare” të ndryshuar, Vendimit te Këshillit te Ministrave nr. 302, datë 11.05.2022 “Politikat Kombëtare për Riorganizimin e Sektorit te Furnizimit me Ujë të Largimit të Ujrave te Ndotura”, Statutin Shoqërisë me nr.1861 Prot. datë 01.09.2022, Rregullorës së brendëshme të Shoqërisë, Marrveshjes për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta të Ujësjiellës Kanalizime Dibër sha, datë 22.07.2022, shpallen procedurat e konkurimit për vend të lirë pune:

1(një) Faturues/Lexues Matësi Uji - Njësia Bulqizë

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore

Faturues/Lexuesi i Matësit të Ujit i Njesisë varet nga ana administrative nga Përgjegjësi i Administratës së Njesisë përkatëse dhe nga ana funksionale nga Drejtori i Drejtorisë Tregtare.

Faturues/Lexuesi i Matësit të Ujit ka këto detyra dhe përgjegjësi;

1. Kryen leximin e rregullt (*mujor*) të matëseve të klientëve që ndodhen në zonën që mbulon.
2. Gjatë leximit të matësit, kryen verifikime mbi gjendjen e matësit në lidhje me funksionimin e tij, vulosjen e tij, ndërhyrjeve të paligjshme dhe problematikave të tjera të ndryshme si rrjedhje, etj.
3. Rezultatet e verifikimeve sipas rastit dhe procedurave të miratuara i regjistron dhe raporton si anomali si dhe mban përgjegjësi për mos-raportimin apo raportimin qëllimisht të gabuar të anomalive.
4. Në fund të ditës dorëzon pranë Operatorit të Sistemit në Njësi, listat e plotësuara të leximit së bashku me regjistrin e anomalive .
5. Kryen shpërndarjen e faturave tek klientët që ndodhen në zonën që mbulon.

6. Kryen verifikime të konsumit dhe matësit në terren në bashkëpunim me Drejtorinë e Task Forcës pranë U.K. Dibër Sh.a. por edhe sipas udhëzimeve të Sektorit të Shitjeve në Drejtorinë Tregtare pranë U.K. Dibër Sh.a.
7. Përfshihet në mënyrë aktive në sqarimin e ankesave të konsumatorëve sidomos për çështje që lidhen me konsumin dhe matësin, duke bashkërenduar me strukturat e shitjes në Njësi, si dhe Sektorin e Shitjeve dhe Sektorin e Marrëdhënieve me Klientin në Drejtorinë Tregtare pranë U.K. Dibër Sh.a. si dhe duke zbatuar udhëzimet e tyre.
8. Është i detyruar të vrojtojë, kontrollojë të gjithë përdoruesit e zonës së tij për të mos lejuar asnjë konsumator pa faturim si pasojë e mos-lidhjes së kontratës. Në çdo rast mund të kërkojë mbështetjen e Drejtorisë së Task Forcës pranë U.K. Dibër Sh.a.
9. Kur konstaton përdorues të cilët nuk faturohen, i paralajmëron ata për shkelje të ligjit dhe njofton menjëherë me shkrim Drejtorinë e Task Forcës pranë U.K. Dibër Sh.a.
10. Mban përgjegjësi për veprime dhe mosveprime që pengojnë plotësimin e detyrave të përcaktuara në këtë rregullore dhe si rrjedhojë në varësi të rrezikshmërisë shoqërore (*dëmit të shkaktuar*) dhe shkallës së paramendimit kjo përgjegjësi ndiqet në mënyrë administrative dhe/ose në rastet kur plotëson elementët e veprës penale të bashkëpunimit në vjedhje të sasisë së ujit të pijshëm, ky rast procedohet për ndjekje penale.
11. Zbaton disiplinën në punë dhe detyrat e përcaktuara në këtë rregullore.
12. Ka detyrimin të përmbushë çdo urdhër tjetër apo porosi (*me shkrim dhe me gojë*) të eprorëve, që nuk përfshihet në pikat më lart, kur nuk përbëjnë shkelje ligjore, dhe që nuk çenojnë dinjitetin e punonjësit.

Kandidatet duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- ✓ Të jenë shtetas shqiptarë;
- ✓ Të kenë përfunduar arsimin e mesëm;
- ✓ Të jenë në gjendje të mirë shëndetësore dhe të aftë fizikisht për të përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë e pozicionit përkatës;
- ✓ Eksperienca në sektorin e ujësjellësit përbën avantazh.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

1. Curriculum Vitae (CV);
2. Fotokopje të kartës së identitetit;
3. Fotokopje të librezës së Punës (nëse disponon);
4. Çertifikatë personale;
5. Çertifikatë e gjendjes familjare;
6. Diplome shkolle (e noterizuar);
7. Listë notash (e noterizuar);
8. Dokumente që vërtetojnë kualifikime ose eksperiencë pune (nëse ka);
9. Dëshmi Penaliteti;
10. Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore;
11. Vërtetim prokurorie;
12. Saktësim adrese nga Bashkia;
13. Raport Mjekoligjor (Aftësi në punë);
14. Foto të vogla dy (2 copë), foto e madhe një (1 copë).

Kandidatet do të vleresohen mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur, përmbushjes së kriterëve të shpallura dhe nevojave të institucionit.

Vetëm kandidatët që plotësojnë kriteret e përcaktuara do të ftohenn për fazat e mëtejshme të procedurës së konkurimit. Kandidati fitues do të njoftohet nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Dibër sh.a sipas procedurave në fuqi.

Kandidatet jo fitues kanë të drejtë të paraqesin ankesë me shkrim pranë Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Dibër sh.a., brenda 3 (tre) ditëve nga data e shpalljes së fituesit. Ankesa protokollohet dhe shqyrtohet nga Sektori Juridik, në përputhje me aktet e brendshme dhe legjislacionin në fuqi.